# LETRA E LEXUESVE: DRITA nr. 20/11998

Luan DODE
FREE UNIVERSITY BRUSSEL
LABORATORY OF HYDROLOGY
PLEINLAAN, 2 — 1050 BRUSSEL
BELGIUM
Tel. 0032/2/629.30.26 (nga ora 9 deri 13)
Fax 0032/2/629.30.22

I nderuar z. Shefki Oseku,

Nëpërmjet z. Lek Pervizi më ra në dorë këto ditë DRITA Nr. 18/1997, dhe kuptohet që, si për herë të parë, i lexova të 50 faqet.

Ne mërgimtarët në Belgjikë akoma nuk kemi mundur të nxjerrim një revistë me tematikë të shumë-llojshme dhe njëkohësisht aktuale. DRITËN e dallon edhe kërkesa për gjuhën letrare të shkrimeve që boton, gjuha shqipe e cila për fat të keq është katandisur në një gjendje me të vërtetë të mjerueshme edhe në botimet shqipe. Mbase mjetet teknike të botimeve tona i mjoftuan, e i kanë përsysh kushtet...

Me rastin që po ju dërgoj No. 10 të KUQE E ZI (me porosi të z. Pervizi nga i cili kemi shumë të fala), po ju shkruaj edhe për dy probleme që më interesojnë e për të cilat do të isha mirënjohës po të kishit mundësi të më ndihmonit.

E para: Cili është burimi nga ku është marrë pjesa e shkrimit të Akademikut R. Qosja botuar në f. 6 i DRITËS Nr. 18/1997. E kam fjalën për pjesën ku flitet për E. Hoxhën. Do të isha i interesuar, më pak, edhe për të lexuar komplet pasazhin.

E dyta: Po i referohem KUQE E ZI Nr. 6, f. 17.

Në Konferencën e Stokholmit të Internacionales së Dytë Socialiste (1917) doli për herë të parë në skenën ndërkombëtare mendësia shqiptare, me një Manifest prej

dy faqesh i cili më vonë është botuar edhe në HISTOIRE DE LA II[e] INTERNATIONALE, Tome 22, f. 833, Genève 1980. Ky manifest ka titullin: ALBANIE (Appel des Socialiste Albanais au Comité Russo-Hollando-Scandinave). Nuk di, në se anë të ndonjë burimi të atyhershëm do të gjendeshin emrat e personave që kanë nënshkruar atë manifest!

Duke ju falënderuar paraprakisht për përgjigjet, të cilat do të dëshiroja të ishin të pavarura nga njëra tjetra, e përfundoj;

me konsideratë,

Bruksel, më 5.2.98

[signature]

Revistë kulturore-informative
Kultur-och informationstidskrift

Shoqata Besa, në Trelleborg -Suedi
Föreningen Besa i Trelleborg-Sverige

# DRITA

Viti III
Nr.20/1998
Çmimi
30:-

## Georg Castrioti - Scanderbeg





(1405 - 17. 01. 1468)

## Gjergj Kastriot - Skenderbeu

**Hero Kombëtar**